

Amanda Cici

Amanda Cici është arkitekthe restauratore, e cila prej 10 vitesh i është dedikuar mbrojtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Që prej janarit 2022, mban postin e Drejtoreshës së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë. Si pjesë e Drejtorisë, ajo ka mbajtur më parë pozicionin e përgjegjëses së Sektorit të Pogradecit, si dhe më pas përgjegjëse e Sektorit të Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore, ku ka qenë autore / bashkautore e projekteve konservuese dhe restauruese. Ka përfunduar studimet Master Shkencor në Arkitekturë dhe Dizajn Urban, si dhe Master në Restaurim Monumentesh Kulture. Ka ndjekur dhe marrë pjesë në konferenca dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, me fokus trashëgiminë kulturore, ndër të cilat prezantimi i vlerave të qytetit të vjetër në Konferencën e 41-të të Trashëgimisë Botërore (UNESCO) në Poloni, si dhe pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme të realizuara nga ICCROM, ICOMOS dhe UNESCO. Në vitin 2025, ka qenë pjesë e publikimit “Nënqytet”, një projekt që synon rizbulimin e shtresave të humbura apo të fshehura të qytetit. Gjatë viteve 2017–2019, ka marrë pjesë në një studim mbi trashëgiminë ndërtimore të zonës së Pogradecit, ku ka kontribuar në udhëzimin dhe ndërgjegjësimin mbi mënyrat specifike të ruajtjes së elementëve tradicionalë dhe restaurimit të duhur në zonat historike. Si pjesë e grupit teknik, ka dhënë kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e dosjes për shpalljen “Pasuri Botërore” të Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të Rajonit të Liqenit të Ohrit (2015–2019). Në vitin 2015, nëpërmjet programit “Ëndrra ime 2015”, ka realizuar projektin “Fototeka Misto Cici”, ku u ekspozua një pjesë e arkivit të fotografit Misto Cici. Ky projekt përbën një eksperiencë unike për qytetin, duke krijuar një dialog mes së shkuarës dhe së ardhmes.

Email: amandacici@drtkkorce.gov.al

Website: drtkkorce.com